



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.32/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në konfliktin administrativ të paditësit “M.” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, në rishqyrtim - rivendosje sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. ... të datës 10.11.2021, e duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 3,403.34€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 29.09.2022 në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, Avokat Kushtrim Bytyqi dhe të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur A.H, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “M...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi Avokat në Prishtinë, në tersi si e bazuar
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/419 i datës 25.07.2017 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “M...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 3,403.34€ (tremijë/e/katërqind/e/tre/euro/e/tridhjetë/e/katër/cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-..., të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Merdare, me kamatë ligjore 8%, nga data e pagesës së detyrimeve doganore

16.06.2017 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata konstaton se kjo lëndë është kthyer në rishqyrtim - rivendosje me aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. ... të datës 10.11.2021, sipas të cilit aktgjykim janë prishur aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.682/2019 i datës 10.07.2020, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1470/2017 i datës 17.04.2019. Lidhur me këtë lëndë kemi edhe Aktgjykim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi nr. AGJ 1860/21 i datës 11.10.2021.

Paditësi “M...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 25.08.2017, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, shkeljes së dispozitave ligjore të UA 11/2009, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së rregullave të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale. Në seancën e shqyrtimit kryesor në rishqyrtim - rivendosje sipas aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. ... të datës 10.11.2021, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se: Mbetemi në tërësi si në të theksuarit në padi, duke konsideruar se e paditura ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenit 33 të KDA-së, lidhur me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009, pasi që paditësi me rastin e paraqitjes së DUD kontestues dhe në procedurën e ankesës tek e paditura i ka bashkangjitur lëndës dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, sikurse janë Pro Fatura e datës 24.02.2017, e cila ka të evidentuar mallin e deklaruar në vlerë prej 22,000.00 USD, si dhe çmimin për vënien e tiketave në përshkrimin e mallit sipas porosisë së paditësit në vlerë prej 1,000.00 €. Paditësi ka vepruar në bazë të kësaj Pro Fature dhe ka realizuar pagesat bankare në dy pjesë me datën 09.03.2017 dhe 06.06.2017, në vlerë të përgjithshme prej 23.000.00 USD, pra në emër të mallit dhe të ngjitjes së tiketave. Pastaj dokumentet që janë bashkangjitur në DUD

janë edhe Kontrata e datës 24.2.2017, e cila ka përmbajtje të njëjtë sikurse Pro fatura si dhe Fatura e mallit në të cilën është evidentuar vetëm malli në vlerë prej 22,000.00 USD. Konsiderojmë se e paditura ka dhënë vërejtje të paqëndrueshme lidhur me rregullsinë e dokumenteve të paditësit, duke theksuar se kontrata nuk është e nënshkruar nga paditësi, sepse konsiderojmë se paditësi edhe nëse nuk e ka vulosur e nënshkruar të njëjtën sepse ka ardhur së bashku me mallin, ka manifestuar vullnetin e tij për këtë raport tregtar me rastin e pagesave të realizuara në emër të këtij transaksioni. E paditura nuk e ka pranuar çmimin e transaksionit të këtij malli lëndor me arsyetimin se posedon të dhëna për mallra të ngjashme me çmime më të shtrenjta, por me këtë rast konsiderojmë se nuk ka bërë krahasim objektivë, sepse ndryshon prodhuesi i mallit, emri tregtar i mallit, sasia e kontraktuar, prandaj, konsiderojmë se edhe ndryshimi i çmimit pasqyron ndryshimet e mallrave. Paditësi për shkak të rivlerësimit ka paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore mjetet në vlerë prej 3,403.34 €, e cila është llogaritur si diferencë në mes të versionit të DUD-it të paraqitur nga paditësi me metodën e vlerësimit 1 rubrika 43 e DUD-it, dhe ati të ndryshuar nga e paditura me metodën e vlerësimit 6 rubrika 43 e DUD-it. Paditësi kërkon kthimin e këtyre mjeteve së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8 % nga data e pagesës 16.06.2017, e deri në kthimin e plotë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 15.02.2019 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Vendimi është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor në rishqyrtim - rivendosje sipas aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.nr. ... të datës 10.11.2021, e autorizuara e palës së paditur deklaroi se : Mbetemi në tërësi pranë përgjigjes në padi, e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuara, i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta refuzoj si të pa bazuar, dhe të lenë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë. Konsiderojmë se aktvendimi kontestues është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi, gjithnjë duke i bazuar në nenin 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të cilat janë marrë nga zhdoganimet e rregullta, që në rastin konkret merren si çmime të besueshme dhe të drejta. Për të marrë një vendim të drejtë në rastin konkret, nga e paditura është kërkuar nga Sektori i Vlerës pranë të paditurës që të caktoj vlerën e mallit të drejtë, ku nga ky Sektor është konfirmuar se vlerësimi fillestar është vlerësim i

drejtë, për arsye se për këtë mall ka çmime edhe më të larta se sa që është caktuar nga Zyra e Pranimit Qendror pranë Doganës, kjo sipas shkresës së këtij Sektori të datës 25.06.2017. Pala paditëse në shkresat e lëndës ka bashkangjitur një Kontratë e cila është identike me Pro Faturën, mirëpo e njëjta nuk i plotëson të gjitha kushtet e një kontrate. Sa i përket vlerës së transaksioneve të cilat nuk përputhen me vlerën e Faturës, është dallimi në mes të transaksioneve dhe Pro Faturës në shumën prej 1,000.00 USD. Andaj, bazuar në thëniet e cekura më lartë, si dhe në arsyetim të aktvendimit kontestues dhe arsyetimet e aktgjykimeve të gjykatës, vërehet ky mos harmonizim, që ky aktvendim konsiderohet si i drejtë. Sa i përket kërkesës së palës paditëse lidhur me kamatën prej 8 %, të njëjtën e kundërshtojmë për arsye se nuk është e cekur në padi. Sa i përket diferencës së mjeteve të paguara më tepër ndërmjet asaj të deklaruar nga paditësi me MV1 dhe asaj të rivlerësuar nga e paditura me MV6, e njëjta shumë është 3,403.34 €, gjë që kjo shumë është identike me shumën e kërkesëpadisë së paditësit, pra kjo nuk është kontestuese. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 29.09.2022, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi nr. ..., DUD R- ... me MV1 dhe MV6, Akti i Inspektimit i Sistemit ASYCUDA për DUD-in kontestues, Pro Fatura ..., Transaksionet Bankare Ndërkombëtare të datës 09.03.2017 dhe 06.06.2017, Fatura ..., Kontrata ...,

Përgjigja në Padi e datës 15.02.2019, E-mailat e datës 25.07.2017, 18.07.2017, 03.07.2017, 30.06.2017, Urdhërpagesa e datës 16.06.2017, së bashku me Pagesën Bankare për taksat e paguara e datës 16.06.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se :

- subjekti “M...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, këtu paditësi, përmes DUD-it nr. R-..., të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Merdare, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit;
- e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes proceseve mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35, i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. ..., në bazë të zhdoganimeve të mëhershme.

Nuk është kontestues as fakti se:

- Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal me Aktgjykimin A.nr.1470/2017 të datës 17.04.2019, e ka refuzuar padinë e paditësit dhe e ka lënë në fuqi vendimin kontestues të të paditurës Dogana e Kosovës;
- këtu paditësi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e për të cilën ankesë Gjykata e Apelit e Kosovës ka sjell Aktgjykimin AA.nr.682/2019 i datës 10.07.2020 me të cilin ka refuzuar ankesën e këtu paditësit dhe ka vërtetuar Aktgjykimin A.nr.1470/2017 të datës 17.04.2019;
- lidhur me këtë lëndë Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ka sjell Aktvendimin ARJ-UZVP- nr. ... datë 28.10.2020 me të cilin ka refuzuar kërkesës e këtu paditësit;
- Paditësi “M...” Sh.P.K. me seli në Prishtinë me datë 24.05.2021, i është drejtuar Gjykatës kushtetuese të Kosovës me kërkesë që ka rezultuar me Aktgjykimin AGJ ... të datës 11.10.2021, i cili përveç tjerash ka shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP- nr. ... datë 28.10.2020;
- Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës kushtetuese me datë 10.11.2021 ka sjell aktgjykimin ARJ-UZVP- nr. ..., sipas të cilit aktgjykim janë prishur aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.682/2019 i datës 10.07.2020, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1470/2017 i datës 17.04.2019 dhe lëndë është kthyer në rishqyrtim/rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, tani pranë kësaj Gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka konfirmuar rivlerësimin sipas DUD-it nr. R- ..., sipas të cilit vendim ka konstatuar se Zyra e pranimit qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Po ashtu e paditura në vendimin kontestues deklaroi se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme për arsye se kontrata nuk i përmban elementet esenciale nuk është e nënshkruar dhe e vulosur, andaj e paditura ka caktuar vlerë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme respektivisht në bazë të zhdoganimeve të mallrave të ngjashme që në rastin konkret Dogana e Kosovës i merr si të dhëna të disponueshme.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it nr. R- ..., të Zyrës së Brendshme Doganore Merdare dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 3,403.34€, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të tillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturave të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transaksioneve bankare si në vijim profatura nr. ... e datës 24.02.2017, e cila është identike në elementet esenciale të mallit me faturën nr. ... e datës 04.04.2017, për DUD-in kontestues R- ..., në vlerë prej 23,000.00 USD (22,000.00 USD vlera e mallit + 1,000.00 USD tarifa e etiketimit), është paguar me transferet bankare ndërkombëtare të datës

09.03.2017 dhe 06.06.2017 e të cilat transfere në kuptim të përshkrimit të pagesës dhe vlerës janë të harmonizuara me profaturën dhe faturën si më lartë.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e vlerës, në bazë të të cilit vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur profatura nr. ... e datës 24.02.2017, e cila është identike në elementet esenciale të mallit me faturën nr. ... të datës 04.04.2017, si dhe kontratën e shitblerjes së datë 24.02.2017, e të cilat janë paguar me transferet bankare ndërkombëtare të datës 09.03.2017 dhe 06.06.2017 . Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimi e kontestuar se në shkresat e lëndës kontrata nuk është e nënshkruar dhe e vulosur dhe se nuk i përmban elementet esenciale të kontratës, për Gjykatën nuk është i bazuar, sepse përveç që mban vulës e shitësit me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr. ... për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që kontrata e shitblerjes është dokument esencial i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 3,403.34€, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të pa drejtë mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it kontestues R-

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasoj e rivlerësimit të mallit nga e paditura u konstatua nga diferencë në mes të versionit të DUD-it, të paraqitur nga paditësi me metodën e vlerësimit 1, rubrika 43 e DUD-it R- ..., dhe ati të ndryshuar nga e paditura me metodën e vlerësimit 6, rubrika 43 e DUD-it, R-..., e të cilën diferencë e vërteton edhe përfaqësuesja e autorizuar e palës së paditur e cila në seancën e datës 29.09.2022, deklaroi se : *“Sa i përket diferencës së mjeteve të paguara më tepër ndërmjet asaj të deklaruar nga paditësi me MV1 dhe asaj të rivlerësuar nga e paditura me MV6, e njëjta shumë është 3,403.34 €, gjë që kjo shumë është identike me shumën e kërkesëpadisë së paditësit, pra kjo nuk është kontestuese “*

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Për kamatën Gjykata ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e KDAK-së, Kodi Nr. 03/L-109, neni 292, pika b), “Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: ((b) Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”, në rastin konkret e njëjta është e aplikueshme ngase këtu paditësi e ka parashtruar si kërkesë dhe në nenet 378 dhe 382 të LMD-së, ndërsa si moment të fillimit të kamatës mori datën e pagesës së detyrimeve doganore të rivlerësuar, (provë : Urdhërpagesa e datës 16.06.2017, së bashku me Pagesën Bankare për taksat e paguara e datës 16.06.2017).

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.32/22 datë 29.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.